

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE
“ Meminaj Group ” sh.p.k

Sot në datën 08.02.2023, z. Dritan Meminaj, vendos themelimin e shoqërisë “ Meminaj Group ” sh.p.k me terma si më poshtë

NENI 1

Shoqëria “ Meminaj Group ” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

NENI 2

Emri i shoqërisë


Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “ Meminaj Group ” sh.p.k

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të saj sigurimin e shërbimeve në fushën e telekomunikacionit, komunikimeve elektronike dhe ofrimit të shërbimeve të medias audio vizuale. Themelimin dhe funksionimin e sistemeve radio telefonike celulareve dhe fikse të teknologjive të ndryshme dhe kerkimin, projektin, vendosja dhe funksionimi i sistemeve të komunikimeve elektrike, përfshirë rrjetet e internetit. Furnizimi dhe tregtimi me pajisje dhe materiale të ngjashme të përdorura në lidhje me sistemet. Prodhimi dhe shfrytëzimi i softwereve të lidhura me dhe për funksionimin e sistemeve elektronike.

Aktiviteti konsiston në fushën e ndërtimit, rikonstruksion, mirëmbajtje dhe zhvillim dekori në mjedis urbane. Prodhim dhe tregtim të materialeve të ndërtimit. Ndërtime civile e industriale, restaturimi, karpentiere, impiante teknologjike dhe të vecanta, etj. Shoqëria mund, në rrugë të instrumentalizuar, të kryejë çdo operacion ndërtimor e imobiliar. Objekti i kompanisë është ushtrimi i aktivitetit në fushën e projektimit dhe ndërtimit të rezidencave të banimit. Fusha e veprimtarisë shtrihet në projektimin e ndërtimeve të objekteve të shërbimit magazinimit e kantinieret. Operohet kryesisht në fushën e ndërtimit dhe do të mbulojë të gjitha llojet e shërbimeve në fushën e ndërtimit duke filluar nga konceptimi i projekt-ideve deri në realizimin e tyre.



NENI 4
Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Llagja nr. 1 Rruga Taulantia Kulla 1 Kati 2 Durres

NENI 5
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 10 000 000 (dhjete milion lekë) ALL.

Dritan Meminaj ne cilesine e ortakut te vetem zoteron 100% te vleres se kuotes e barabarte me nje kuote me nje vlere te pergjithshme prej 10 000 000 (dhjete milion leke) ALL

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

NENI 6
Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pakufizuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7
Organet Drejtuese


Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara ç’do organi administrativ, gjyqësor, apo ç’do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Administratori i shoqërisë është z. Dritan Meminaj i datelindjes 07.02.1971 ne Belishove Fier, shtetas shqiptar madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar identifikuar me ID ne. H10207120N ne cilesine e ortakut te vetem te shoqërisë "Meminaj Group" sh.p.k



Shoqëria do të përfaqësohet përprapa çdo organi administrativ, gjyqësor apo vdo enti tjetër publik ose provat në marrëdhënie me të tretet nga administratori i shoqërisë i cili ushtron të drejtat e tij në përputhje me statutin e shoqërisë dhe legjislacionin shqiptarë në fuqi

NENI 8 **Eksperti Kontabël**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

NENI 14

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 5 (pesë) kopje.

ORTAKËT

Shoqëria "Meminaj Group" sh.p.k
Me administrator
Dritan Meminaj

